



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Kuvendi i Kryeqytetit
Skupstina Glavnog Grada –Municipality of Prishtina

E K S T R A K T

i mbledhjes së tretë i Komitetit për Arsim, mbajtur më 12.4.2023, duke filluar në orën 17:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fatmir Dervishi, Lindita Rexhepi, Ajet Brajshori.

Munguan: Berna Saraçi, Gjylbehare Llapi.

Në mbledhje mori pjesë edhe Lulzim Vrapca.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesi i Komitetit z. Fatmir Dervishi, duke paraqitur këtë:

R E N D D I T E

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja paraprake;
2. Procesi i vlerësimit të nxënësve në pjesën e parë të periudhës së dytë;
3. Diskutim për dokumentin e garave, të aprovuar nga anëtarët e komitetit në mbledhjen paraprake;
4. Procesi i zgjedhjes së drejtorëve në shkollat e mesme të larta dhe IP (Institucionet parashkollore);
5. Të ndryshme.

Ajet Brajshori – para se të fillohet me pikat e rendit të ditës tha se sa i përket E- shkollorit as në të kaluarën nuk kemi pasur ndonjë performancë aq të mirë. Pra ndoshta duhet të mendojmë se a duhet të vazhdohet apo jo.

Lulzim Vrapca – lidhur me diskutimin e z. Brajshorit për E- shkollorin tha se ne i marrim të dhënat, p.sh. sa janë të shkëlqyeshëm, si dhe ju themi të gjithë drejtorëve të shkollave, që në fund të gjysmëvjetorit të parë të gjitha të dhënat që i keni t'i inkuadroni në E-shkollor.

Ajet Brajshori – tha se pasi që tash është periudha e parë e gjysmëvjetorit të dytë dhe duhet ta kenë nga një notë, si do t'i merrni këto statistika, duke shtruar pyetjen pastaj - A i merrni direkt nga shkolla?

Lulzim Vrapca - tha se gjithsesi se duhet t'i marrim, vetëm se duhet ta gjejmë një mënyrë. Ai në vazhdim tha se para një jave e kemi pas temë me zyrtarët tanë që derisa të bëhet ajo, ne duhet ta gjejmë një alternativë. Pra duhet me përgatit një excel dhe me ua dërguar shkollave, e dini vetë, pasi që edhe vet keni qenë drejtor.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja paraprake

Fatmir Dervishi - sa i përket ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar tha se kam vetëm një ndërhyrje të vogël aty ku është shënuar Skënderbeu duhet të jetë Skënder Berani.

Pika e dytë

Procesi i vlerësimit të nxënësve në pjesën e parë të periudhës së dytë

Me pajtim të anëtarëve të komitetit kjo pikë është shtyrë për mbledhjen e radhës.

Pika e tretë

Diskutim për dokumentin e garave, i aprovuar nga anëtarët e komitetit në mbledhjen paraprake

Ajet Brajshori - lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se në takimin e kaluar kam pas një pyetje rreth bursave, në ç' rast kishte pyetur se a ka mundësi që i njëjti student të marrë bursë edhe nga komuna edhe nga fakulteti, pasi që e dimë se edhe komuna ka ndarë bursa, mirëpo për këtë pyetje nuk kemi marrë përgjigje. Çështja tjetër është, megjithëse ka kaluar koha, por pata propozuar që në rastin e 7 Marsit të ftohen veteranët e Komunës së Prishtinës në një takim rasti, takim nderi, takim falënderimi. Kanë mbet me na informuar brenda këtyre ditëve dhe akoma nuk kam marrë informata.

Fatmir Dervishi - duke u ndërlidhur në diskutimin e z. Brajshori tha se qysh në fillim të marsit ia kam dërguar drejtoreshës dokumentet, si dhe draftin në të cilin e kemi përmirësuar. Po ashtu edhe kërkesën që e kemi bërë për rastin e Ditës së Mësuesit 7.3.2023, të shpërndahen mirënjohje për veteranët e arsimit të Prishtinës nuk kemi ende përgjigje.

Lulzim Vrapca - sa i përket mirënjohjeve, tha se Kryetari e ka bërë organizimin në shkollën "Eqrem Qabej" për ndarje të mirënjohjeve për veteranët e arsimit, ku së bashku me Rolandin dhe të tjerët e kanë caktuar agjendën e këtij organizimi, duke i përfshirë jo vetëm mësimdhënësit, por edhe punëtorët teknikë, ata që dalin këtë vit, por edhe ata që kanë dal në pension. Në fund tha se mua personalisht ma ka kërkuar listën për arsye se po dëshirojnë t'i ftojnë si organizim nga Kryetari, kurse dhe unë kam qenë në atë takim. Pastaj tha se sa i përket çështjes së bursave janë ndarë 120 mijë euro, siç janë ndarë edhe në vitet tjera. Ai në vazhdim tha se Kryetari i ka nënshkruar dy vendime: njëra për amendamentimin e rregullores për bursa në kuadër të së cilës parashihet pikërisht kjo pika e rendit të ditës që e kemi para vetes sot, që të hyjë në kuadrin e një mozaiku të garave shkollore, kurse sa i përket pyetjes se a ka të drejtë që një student të marrë bursë edhe prej komunës edhe prej fakultetit natyrisht se nuk ka të drejtë. Ai mes tjerash tha se sa i përket garave shkollore ashtu siç e keni paraparë edhe ju prof., me siguri që keni me qenë edhe ju prezent në takim sepse ka ardhur

vendim prej zyrës ligjore ku na është thënë se listën që e kemi pasur prej 16-20 personave e më duhet ta ngushtojmë, dhe me rekomandimin e tyre i kanë lënë 7 apo 8 në kuadër të vendimit. Por gjithsesi kur të mbahet takimi i parë do të ju ftojme edhe juve sepse pikërisht lidhet me këtë pikën që e kemi sot para vetes ku aty është Donjeta nënkryetarja si kryesuese e këtij grupi dhe do ta marrim përsipër totalisht se si parashihen që me i pas si lloj të pakove të nxënësve, vendi i parë.. ashtu siç e keni parashikuar edhe ju, që mua më ka pëlqyer shumë nga ky grup punues. Vendi i parë, i dytë, i tretë, i katërt.. në gara të diturisë. Kjo është ajo që ndërlidhet me pyetjen përkatëse.

Fatmir Dervishi - tha se meqë garat janë pak të sikletshme duken të lehta, por secili fëmijë e ka një farë stresi kur hyn në gara, prandaj do të ishte mirë që nëse ka ndonjë datë përafërsisht që është caktuar më 6 prill apo 6 maj, të paktën të kenë një kohë që mund të përgatiten apo nga 15 - 25 maj, sepse si drejtorët ashtu edhe profesorët kanë dëshirë që me dalë mirë, prandaj do të ishte mirë me t'ju përcjellim shkollave si informatë.

Lulzim Vrapca - tha se edhe këtë vit sikurse vitet e kaluara është e pamundur të miratohet rregullorja brenda këtyre 2 apo 1 muaji shkollor që ka mbetur sepse janë disa procedura, kështu që ashtu sikurse viteve të tjera garat e diturisë do të organizohen nga Drejtoria e Arsimit. Pasi në lëndët përkatëse, në gjuhë shqipe, matematikë. Pra, janë disa lëndë që i kemi organizuar çdoherë si drejtori, ato do të organizohen edhe këtë vit njëjtë, ndërsa sa i përket asaj idesë tuaj, duhet të miratohet diku kur ka implikime financiare, prandaj unë po them që atë ide të cilën unë e kam shqyrtuar edhe me drejtoreshën dhe tha që është shumë mirë, vetëm e shqyrton ky grupi, e shqyrtojmë bashkërisht dhe nuk ka asnjë problem ta procedojmë tutje (pra, si informatë për t'i njoftuar jo një javë përpara, por një muaj më herët).

Pika e katërt

Procesi i zgjedhjes së drejtorëve në shkollat e mesme të larta dhe IP (Institucionet parashkollore)

Lulzim Vrapca - sa i përket zgjedhjes së drejtorëve në shkollat e mesme të larta dhe IP (Institucionet parashkollore) tha se realisht ka qenë në kuadër të Këshillit britanik që ka pasur komisioni, ka pasur takime të vazhdueshme me ta për sa i përket strukturimit dhe mbajtjes së organizimit të këtij procesi. Të them të drejtën edhe ministria i ka propozuar sepse çdoherë në çdo fazë të konkursit kur shpallet, çdoherë duhet ta propozojnë një kandidat, do të thotë kandidatin e ministrisë - përfaqësuesin e ministrisë, është procedurë. Tutje tha se në koordinim me të gjitha proceset organizative administrative janë shpallur ato konkurse që veçse i keni parë. Në rishpallje ka qenë "Hoxhë Kadri Prishtina", "7 Shtatori" dhe gjimnazi matematikor, rishpallje, që do të thotë herën e parë janë anuluar për shkak të mospërmbushjes së kriterëve. Në udhëzim administrativ thotë që duhet të jenë së paku 3 kandidatë që i plotësojnë kriteret. Ai në mes tjerash tha se në shpalljet tani janë "Eqrem Qabej" dhe zëvendësdrejtori i "Ahmet Gashi", ndërsa anulohen shkollat: "Prenk Jakova", "28 Nëntori", "Gjin Gazulli" dhe "Ali Sokoli". Do të thotë anulohen sepse nuk kanë pas kandidatë. Është hera e parë që është shpallur konkursi për këto dhe realisht nuk ka kandidatë që i plotësojnë kriteret ligjore siç e jep udhëzimi administrativ. Do të thotë aty e plotëson një, e të tjerët nuk e kanë plotësuar. Kështu që kjo është arsyeja pse ka marrë komisioni vendim që të anulohen.

Ajet Brajshori - duke u ndërlidhur në diskutim tha se do të thotë nuk ka pas treshe me i plotësuar kriteret, vetëm për këta sepse aty shkruan për mosplotësimin e kriterëve dhe nuk po e dimë se çfarë.

Lulzim Vrapca - tha se ka pasur raste që kanë qenë 4 ose 5, ato statistika nuk i kam këtu, mirëpo shkollat e cekura si "Prenk Jakova", "28 Nëntori", "Gjin Gazulli" dhe "Ali Sokoli", këto anulohen. Këto do të shkojnë në rishpallje (Besoj që javën e ardhshme do të shpallen këto, pas 8 apo 9 ditëve ato duhet të shpallen).

Ajet Brajshori - tha, do të thotë se e njëjta situatë qenka edhe me çerdhe.

Lulzim Vrapca - tha, edhe me çerdhe është e njëjta situatë. Me çerdhe është edhe më keq sepse këtu janë 3 e aty ka qenë 1, një kandidat që i ka plotësuar kushtet. Ai mes tjerash tha se realisht me qenë sot drejtor në shkollë është një përgjegjësi jashtëzakonisht shumë e madhe. Vetëm një ekskursion ta realizosh, çfarë barre e përgjegjësisë është. Ai tha mund unë kam treguar gatishmëri dhe kam ndihmuar rreth ekskursionëve kohëve të fundit, duke ua realizuar disa dokumente, pastaj në oferta, kontrata si lidhet, për t'ua bërë të gjitha shkollave si standard që kur ta plasojnë në media me qenë me të vërtetë mirë, dhe përkundër të gjitha përgjegjësive që kanë, drejtorët i kanë pagat e ulëta. Pra realisht tani po e shoh që kjo është gjendja e mosinteresimit.

Fatmir Dervishi - duke u ndërlidhur në diskutim tha se e kisha bërë një rekomandim që është mirë me ia drejtuar edhe drejtoreshës, që të diskutohet shumë seriozisht paga e drejtorëve. Pra mund të takohet me Arbërie Nagavcin dhe Hekuran Muratin, është qesharake se çfarë ka ndodhur me këtë listë të pagave sidomos me drejtorët, sepse drejtori i shkollës i ka vetëm 50 euro më shumë se unë.

Ajet Brajshori - duke u ndërlidhur në diskutim tha se unë jam ithtar i respektimit të ligjit dhe udhëzimeve administrative. Ndoshta shumëherë nuk japin rezultate të mira sepse praktika e terreni na kërkojnë tjera rrethana. Përderisa jemi tek konkursi e kam edhe një pjesë vetëm sa për të plotësuar profesorin, normalisht më vjen mirë që duhet të plotësohen kriteret në shpalljen për herë të parë. Të gjithë kandidatët duhet me qenë kandidatë potencial në konkurrim që edhe kur të vijnë në intervistë mos të vijnë vetëm për plotësim numri, por të tregojnë performancën e tyre për menaxhim dhe udhëheqje sepse ka aplikuar dhe duhet me pa se ndoshta në mesin e atyre të treve diku e kemi fokusin se do të jetë i mirë, por nëse të tre janë të përgatitur mirë dhe i plotësojnë kriteret, ndoshta ai i treti jep performancën më të mirë që nesër ta kemi një shkollë të mirë. Nuk ka shkollë të mirë pa drejtor të mirë. Ai mes tjerash tha se ndonjëherë në këto takimet tona ndoshta dikush ka menduar që unë kam ndonjë interes, por jo, unë e kam interes arsimin sepse është interes nacional dhe nga përvoja ime, nga bagazhi im dhe eksperiencia ime, do të mund të jap më të mirën të mundshme, kështu që nuk është fjala ime e fundit që është më e mira sepse bashkërisht mundemi me e nxjerrë më të mirën. Pra nëse ne jemi në rrjedhë dhe i akordojmë të gjitha qëndrimet mbështetur në këto ligje dhe udhëzime administrative, gabimet do të jenë më të vogla e sukseset më të mëdha, e me këtë nuk po them që jemi absolut të pagabuar. Ai mes tjerash tha se në kuadër të konkursit kemi pas një tejkalim të anashkalimit të individëve në konkurs, p.sh., në shkollën "Ahmet Gashi" pse nuk është hapur konkursi për drejtor?. Për këtë rast ai kërkoi sqarim, mandej pyeti edhe për shkollën "Xhevdet Doda" pse nuk është hapur konkurs, duke shtuar se pozita e zëvendësit po dhe e drejtorit jo. Në fund shtroi pyetje se: a ju ka ardhur juve një letër prej një prindi lidhur pikërisht me shkollën "Ahmet Gashi" se pse nuk është

shpallur konkursi. Pyetja tjetër ishte se: a ju ka ardhur një letër pas 10 ditëve edhe për një vepër (uroj të mos jetë) lidhur me notimin e 43 nxënësve të vitit të kaluar. Lidhur me këtë kërkoi sqarim se a janë me këto problematika.

Lulzim Vrapca - duke ju përgjigjur z. Brajshori tha se po na ka ardhur dhe jemi marrë me këto, dhe në vazhdim dha sqarime lidhur me çështjet e shtruar që kanë të bëjnë me zgjedhjen e drejtorëve.

Pas shumë diskutimesh, sugjerimesh dhe propozimesh nga anëtarët e komitetit u tha se nuk janë në fokus individë, por është ligjshmëria. Ne jemi për ta bërë një rregull e jo një anarki që na ka përcjellë për 5-6 vite.

Pika e pestë

Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë nuk pati se çka të diskutohet

Mbledhja përfundoi në orën 18:10

Procesmbajtësja
Lendita Spahija


Kryesuesi i Komitetit
Fatmir Dervishi

